Women in Mathematics



Hypatia
(355–415/416)

SHQUHET PËR: të qenurit gruaja e parë që ofroi kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e matematikës.

Émilie du Châtelet
(1706–1749)

SHQUHET PËR: përkthimin dhe komentet mbi librin 'Principia' të Isaac Newton. Përkthimi dhe komentet e saj konsiderohen akoma përkthimi zyrtar i librit në frengjisht.

Maria Agnesi
(1718–1799)

SHQUHET PËR: të qenurit gruaja e parë që ka shkruajtur në libër matematike. Ajo ishte gjithashtu gruaja e parë e caktuar si profesoreshë matematike në një universitet.

Marie-Sophie Germain
(1776–1831)

SHQUHET PËR: korrespondencën e saj me Lagrange, Legendre dhe Gauss nën një pseudonim burri. Ajo ishte një nga pionerët e teorisë së elasticitetit dhe kreu punë thelbësore mbi Teoremën e Fundit të Fermasë.

Mary Somerville
née Fairfax
(1780–1872)

SHQUHET PËR: të qenurit një polimatematiciene që studioi matematikë dhe astronomi. Ishte një nga dy gratë e para që u zgjodhën si Anëtare Nderi të Shoqatës Mbretërore Astronomike. Kolegji Somerville i Universitetit të Oksfordit është emërtuar në nder të saj.

SHQUHET PËR: bashkëpunimin e saj me Charles Babbage mbi propozimin e tij për një motor analitik. Ajo zbuloi se motorri mund të përdorej për më tepër se thjesht përllogaritje dhe shkruajti algoritmin e parë që mund të zbatohej nga një makineri e tillë.



Ada Lovelace
(1815–1852)



Florence Nightingale
(1820–1910)

SHQUHET PËR: (përveç të qenurit themeluesja e infermjerisë moderne) punën e saj në statistikë, si për shembull, shpikjen e grafikut pite, të cilin e përdori për të përkthyer numrat për publikun dhe politikanët.

SHQUHET PËR: punën e saj në analizë, ekuacionet diferenciale të pjesshme dhe mekanikë. Ishte gruaja e parë që u emërua profesoreshë e plotë në Europën Veriore dhe një nga gratë e para redaktore të një reviste shkencore.

Sofya Vasilyevna Kovalevskaya
(1850–1891)

SHQUHET PËR: shpikjen e termit politop, një trup katër-dimensional konveks dhe për zbulimin e gjashtë trupave të rregullt të tillë.



Alicia Boole Stott
(1860–1940)

SHQUHET PËR: të qenurit gruaja e parë që arriti rezultatin maksimal në testin e Cambridge Mathematical Tripos. Asaj nuk iu dha titulli i Senior Wrangler, pasi në atë kohë vetëm burrat emëroheshin.



Philippa Garrett Fawcett
(1868–1948)

Emmy Noether
(1882–1935)

SHQUHET PËR: punën e saj në algjebrën abstrakte dhe fizikën teorike. Veçanërisht për teoremën e Noether-it dhe unazën e Noether-it, të dyja për fizikën e grimcave elementare dhe relativitetin e përgjithshëm.



Mary Lucy Cartwright
(1900–1998)

SHQUHET PËR: të qenurit një nga pionerët e teorisë së kaosit. Cartwringt ishte gruaja e parë që u bë Fellow e Shoqatës Mbretërore, morí çmimin Sylvester, ishte presidentja e Shoqatës Matematikore dhe të Shoqërisë Matematikore të Londrës.

Gertrude Mary Cox
(1900–1978)

SHQUHET PËR: punën e saj mbi dizenjot eksperimentale në statistikë. Cox ishte gruaja e parë e përzgjedhur nga Instituti Ndërkombëtar i Statistikës.

Marie-Louise Dubreil-Jacotin
(1905–1972)



Ruth Moufang
(1905–1977)

SHQUHET PËR: të qenurit gruaja e dytë me doktoraturë në matematikën e pastër dhe profesoresha e parë matematike në Francë. Përveç eksperizës së saj në mekanikën e lëngjeve dhe algjebrën abstrakte, ajo shkruajti një botim mbi historinë e matematikës.

SHQUHET PËR: punë revolucionare mbi strukturat algjebrike jo-shoqërore, përfshirë këtu loop-at Moufang të cilat mbajnë emrin e saj dhe një degë të re në gjeometri të quajtur sipërfaqet Moufang.

Dorothy Vaughan
(1910–2008)

Katherine Johnson
(1918–2020)

Mary Jackson
(1921–2005)

Rózsa Péter
(1905–1977)

SHQUHET PËR: të qenurit gruaja e parë hungareze me titullin Doktor Akademik në matematikë. Njihet si 'nëna themeluese e teorisë së rekursionit'. U nderua me disa çmime dhe ishte gruaja e parë që u përzgjodh në Akademinë Hungareze të Shkencave.

SHQUHET PËR: të qenurit një shkencëtare kompjuterike me doktoraturë në matematikë. Ajo shpiku një nga linqet e para dhe themeloi teorinë e gjuhëve programuese për makineritë e pavarura.



Grace Brewster Murray-Hopper
née Murray
(1906–1992)

Joan Elisabeth Lowther Murray
née Clarke
(1917–1996)

SHQUHET PËR: të qenurit praktikuesja e vetme e Banburismit (një proces kriptoanalitik i zhvilluar nga Alan Turing gjatë Luftës së Dytë Botërore) gjatë rekrutimit të saj në Shkollën Shtetërore të Kodit dhe Shifrave. U bë më pas nëndrejtoresha e seksionit të saj.



Melba Roy Mouton
(1929–1990)



Christine Darden
(b. 1942)

Gratë-kompjuter të NASA-s

Një grup matematicienesh, grave-kompjuter dhe më pas programuesesh në NACA, NASA dhe Qendrës Kërkimore Langley që kontribuan në Konkursin Hapësinor Amerikan.

Fillimisht me 5 matematiciene në staf në 1935, ndërsa në 1946 me 400.

ANËTARE TË DALLUARA JANË:
Dorothy Vaughan,
Katherine Johnson,
Mary Jackson,
Melba Roy Mouton, dhe
Christine Darden.

Phyllis Nicolson
née Lockett
(1917–1968)

SHQUHET PËR: punën e saj në analizën numerike me John Crank në lidhje me metodën Crank-Nicholson. Gjatë studimeve doktoratorale të saj në Universitetin e Manchester-it, u bë një përdoruese eksperte e analizuesit diferencial të Hartree-s.



Julia Robinson
(1919 – 1985)

Burimi: Arkivat e Matematikës

SHQUHET PËR: hkontributin e saj në teorinë përllogaritëse dhe teorinë e kompleksitetit përllogaritës.

Olga Aleksandrovna Ladyzhenskaya
(1922–2004)

SHQUHET PËR: punën e saj mbi ekuacionet diferenciale të pjesshme, dinamikën e lëngjeve dhe konvergjencës së metodave të pjesshme diferenciale për ekuacionet e Navier-Stokes. Ishte në listën e kandidatëve për medaljen Fields në 1958.

SHQUHET PËR: kontributin e saj në edukimin matematikor dhe publikimet matematikore. Ajo prezantoi përfshirjen e aftësive gjuhësore në edukimin matematikor.

Anneli Lax
(1922–1999)

Yvonne Choquet-Bruhat
(b. 1923)

SHQUHET PËR: kontributin e saj në studimin e teorisë së relativitetit të përgjithshëm të Einstein-it. Ishte gruaja e parë që u përzgjodh si anëtare e plotë e Akademisë Franceze të Shkencave dhe është Oficere e Lartë e Légion d'honneur.

Olga Arsenievna Oleïnik
(1925 – 2001)

SHQUHET PËR: punën e saj pionere në teorinë e gjeometrisë algjebrike, ekuacioneve diferenciale të pjesshme, teorinë e johomogjenitetit të fortë të objekteve elastike, si dhe në teorinë matematikore të shtresave kufitare.

María Wonenburger
(1927–2014)

SHQUHET PËR: punën e saj mbi teorinë e grupeve dhe algjebrave Lie. Ishte gruaja e parë me origjinë spanjolle që fitoi një bursë Fulbright për studime doktorale në matematikë.

Shakuntala Devi
(1929–2013)

Kredite: Hetvee Patel, përmes Wikimedia Commons

SHQUHET PËR: të fituarit një vend në edicionin e vitit 1982 të librin të Rekordeve Botërore Guiness për aftësitë e saj aritmetike. Njihej si "Kompjuteri Njerëzor" (ajo shumëzoi me mendje dy numra 13-shifror për 28 sekonda).

Marina Evseevna Ratner
(1938–2017)

SHQUHET PËR: punën e saj mbi teorinë ergodike. Ajo vërtetoi teorema në lidhje me rrymat unipotente në hapësira homogjenike, të njohura si teoremat e Ratner-it, dhe fitoi disa çmime për punën e saj.

Nancy Jane Kopell
(b. 1942)

SHQUHET PËR: punën e saj në fushën e biomatematikës së aplikuar me kontribut në mbi 200 artikuj kërkimor të publikuar. Ishte drejtoresha dhe bashkëthemeluesja e Cognitive Rhythms Collaborative. Fitoi disa çmime, përfshirë çmimin John van Neumann.



Idun Reiten
(b. 1942)

Kai T. Dragland / NTNU

SHQUHET PËR: punën e saj mbi teorinë e përfaqësimit. Fitoi mjaft çmime dhe vlerësim për punë kërkimore të dalluar. Në 2014, u emërua si komandante e Urdhërit të St. Olav nga mbreti norvegjez për punën e saj në matematikë.



Karen Uhlenbeck
(b. 1942)

Andrea Kane, Institute for Advanced Study

SHQUHET PËR: të qenurit themeluesja e analizës gjeometrike moderne.

Ingrid Daubechies
(b. 1954)

Les Todd, Duke Photography

SHQUHET PËR: punën e saj mbi përdorimin e metodave matematikore për zhvillimin e teknikave të përpunimit të imazheve. Emri i saj lidhet me valët të cilat përdoren në standartet e JPEG 2000. Mori mjaft vlerësime dhe çmime, duke përfshirë çmimin e Princeshës së Asturias (në 2020) për Kërkim Shkencor dhe Teknik.

Claire Voisin
(b. 1962)

Me lejen nga Claire Voisin

SHQUHET PËR: punën e saj në gjeometrinë algjebrike sidomos mbi teorinë Hodge dhe aplikimet e saj në probleme konkrete klasike.

Maryam Mirzakhani
(1977–2017)

Burimi: National Science Foundation

SHQUHET PËR: të qenurit personi i parë me origjine iraneze që mori çmimin Fields dhe gruaja e parë deri më sot. Temat e saj kërkimore përfshijnë teorinë Teichmüller, gjeometrinë hiperbolike, teorinë ergodike dhe gjeometrinë simplektike.

The Netherlands

UNIVERSITY OF EXETER

Ky projekt u zhvillua dhe u koordinua nga znj. Silvy Hendriks, dr. Houry Melkonian, dhe prof. Maria Vlasiou. Kontribute shtesë u bënë nga dr. Tom Ritchie dhe studentët në vijim të Universitetit të Exter-it: Amber Ellis, Sophia Jaffer, Anila Navaratnam, dhe Sophie Peel.

Dizenjuar nga Jana Kleineberg | kleineberg.co.uk